



Aplikantët për leje drejtimi automjeti që disponojnë lejen e praktikantit të ri (klasa DJ ose MJ) duhet t'i dorëzojnë këtë vërtetim të plotësuar kontrollorit të lejes së drejtimit për mjete motorike në çdo provim praktike. Aplikantët duhet të kenë drejtuar automjetin të paktën 50 orë me mbikëqyrje, duke përfshirë 15 orë pas perëndimit të diellit. Numri i orëve të drejtimit të automjetit me mbikëqyrje në një kurs formimi të certifikuar për drejtues automjeti konsiderohet pjesë e 50 orëve të kërkuara dhe mund të vërtetohet më poshtë.

Emri i aplikantit _____ Leja e praktikantit _____
Numri i identifikimit _____
Adresa _____

SHËNIM PËR PRINDIN OSE KUJDESTARIN E DREJTUESIT TË RI TË AUTOMJETIT: Ju mund ta anuloni pëlqimin që keni dhënë kur drejtuesi i ri i automjetit i përshkruar më sipër të ketë depozituar një aplikim për leje drejtimi ose licencë për drejtues automjeti. Për të anuluar lejen ose licencën e drejtuesit të ri të automjetit të klasës DJ ose MJ, plotësoni formularin MV-1W (Anulimi i pëlqimit) dhe dorëzoni formularin pranë DMV-së.

VËRTETIM

Unë vërtetoj se jam prindi/kujdestari ose përfaqësues i një agjencie ose institucioni qeveritar. Gjithashtu vërtetoj se aplikanti ka kryer të paktën 50 orë drejtimit të mbikëqyrur të automjetit, duke përfshirë 15 orë pas perëndimit të diellit. Unë e kuptoj se disa ose të gjitha orët e kërkuara të drejtimit të mbikëqyrur të automjetit mund të jenë kryer me një instruktor të licencuar për autoshkollë ose me një mësues për formimin e drejtuesve të automjeteve dhe se këto orë mund të vërtetohen më poshtë. Unë vërtetoj se çdo orë e drejtimit të mbikëqyrur të automjetit që nuk është kryer me një instruktor të licencuar për autoshkollë ose mësues për formimin e drejtuesve të automjeteve është kryer: 1) nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një personi të paktën 21 vjeç, i cili disponon një leje drejtimi të vlefshme në shtetin e Nju Jorkut për të drejtuar llojin e automjetit që është përdorur, dhe 2) në përputhje me çdo kufizim rajonal të zbatueshëm për drejtimin e një automjeti me anë të lejes së praktikantit të ri në atë zonë. Unë e kuptoj që falsifikimi i çdo informacioni në këtë vërtetim mund të përbëjë një krim (vepër penale ose kundërvajtje), i cili dënohet me gjobë, me burgim ose të dyja.

Emri me germa shtypi i prindit/kujdestarit ose përfaqësuesit të një agjencie/institucioni qeveritar _____

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit ose përfaqësuesit të një agjencie/institucioni qeveritar **X** _____ Data _____

Emri i institucionit qeveritar (ka) _____

MV-262AL (4/23)

Numri i orëve të drejtimit të automjetit nën mbikëqyrjen e një instruktori për autoshkollë ose mësuesi për formimin e drejtuesve të automjeteve mund të vërtetohet në tabelën e mëposhtme. I gjithë informacioni i paraqitur në këtë tabelë duhet të konfirmohet nga të dhënat e kërkuara sipas rregulloreve të Departamentit të Mjeteve Motorike dhe Departamentit të Shtetit për Arsimin. Çdo deklaratë e rreme përbën shkelje të nenit 392 të ligjit "Për automjetet dhe qarkullimin rrugor" dhe konsiderohet si kundërvajtje.

Emri i shkollës	Numri i licencës së autoshkollës	Emri i instrukturit	Numri i certifikatës së instrukturit	Numri i orëve të vërtetuara	Nënshkrimi i administratorit, pronarit ose instrukturit

